


Teodor Keko



**Zemra
nuk ēshtë
kēmishē**



Poēzij

884-1
K42

Teodor Keko

ОДНАК - ОЛСОА

Zemra
nuk është
këmishë



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Kaukäte
ber ujezjnu

zakaznik

zakaznik zemel'nyj

NAIM FRASHËRI

«Ish natë dhe dita s'gdhihej»
dhe ti gjoksin qiri.
Pak ditë syve të ngihej
nga ëndrra Shqipëri.
Po gjoksi është gjoks,
i brishtë dhe me cak,
kjo ditë që s'agte dot

të treste pak nga pak,
Dhe ç'fatkeqësi e tmerr
të kesh diell në penë,
ndërkokë rrëth teje ferr,
një hënë që shqyejnë qentë.

«Ish natë dhe dita s'gdhihej»
dhe histori e rëndë,
po floku yt që thinjej
ish dritë e argjendtë.

GRATË

Grua,
fytyrë e pastër,
stинë e bukur.
Gjithnjë 16 vjeç.

Grua,
pasqyrë
ku ne shohim vetveten
lakuriq,
pa maskën e shtirjes,
prepotencën shefore,
buzëqeshjen lypsare për interes.

Gra,
te ju
të bukur e njerëzorë
ribëhemë.
Dhe çudi:
atje ku jeton gruaja
si ka mundësi
me dy fytyra të jemi?

E DI, PAS DERE DO PRES NJË ÇAST

Do lindë një foshnjë,

Në portën time po trokas
si zakonisht, në mbrëmje vònë.
E di, pas dere do pres një çast,
grimohen lodhjet ndërkaq në dhomë.

Eshtë gruaja ime e rraskapitur,
në fytyrë po hap pak krem.
Ajo, e bukura e botës,
s'ka forcë të qeshë. Dhe buzëqesh!

Ka mbajtur djalin, ka bërë gjellën,
shkruar ditarin, larë shtëpinë,
ka pritur miqtë, ka larë enët,
ka ndezur zjarrin dhe dashurinë.

Dhe rraskapitjen kyç brenda vetes,
se dashuron, s'thotë dot «u lodha»!
Si Galile më vjen të them:
— Rreth dashurisë värtitet bota!

SELVITË NË VARREZA

*Do bjerë një shi
dhe ti do rritesht.*

*Do bjerë një borë
dhe unë do thinjem.*

*Do dalë një diell
dhe ti do piqesh.*

*Do nisë një vapë
dhe unë do digjem.*

*Ti një cigare do pish në dhomë,
tymi tek unë do vijë selvi.*

*Selvinë, ju lutem, mos e prisni!
Është trishtim. Pra, dashuri.*

1986

KJO FOSHNJË QË LËVIZ NË BARK TË NËNËS

Do lindë një foshnjë.

*Nëna i thur trikot,
kapuçet.*

Foshnja lëviz në bark.

Krijesa e re nuk do

në modele të vjetra të futet.

T A N I

Djali im më lutet t'i ndërtoj një varkë
të pambytshme
në udhën për zbulime të largëta,
i bindur se botë
është më e madhe nga e tashmja.

Në limanin e netëve të pagjuma
ndërtova varkën.

Gruaja më lutet t'i shkruaj
një ninullë magjike në murin e shtëpisë
të këndueshme nga ajri
dhe të aftë të tundë fëmijët
në një gjumë plotë ndrra qeshjendjellëse
me kokën mbështetur pranë bukurisë.

Në braktisjen e lektisjes së vogël mizore
shkruajta ninullën.

Tani mbaj aromë të mirë,
aromën e foshnjës së gjirit.

SË PARI, DASHURIA NJERËZORE

1.

Njeriu që pikturonte me talent gjeniu
qiellin s'pëlqeu për telajo
por një kanavacë të matshme me pëllëmbë.
Dhe ngjyrat i përftoi nga shtrydhja e
vështrimit
mbi të gjelbrat e barit, të kaltrat e detit, të
verdhat mbi hënë.
Pastaj pikturoi në vaj njeriun
dhe telajo në qiell u shndërrua vetë
dhe e gjelbra-bar dhe e kaltra-det
dhe e verdha-hënë dhe e hirta-qiell i
shkretë.

Gjithçka jetë!

2.

Poeti që thurte vargje të mahnitshme
nuk zgjodhi për letër kujtesën,
por një copëz të matshme me gishterinj
dhe bojë
çka kulloi prej shtrydhjes së zemrës.

Pastaj, kur hoahi në varg njeriun
letër u bë kujtesa vetë
dhe e gjelbra-bar dhe e kaltra-det
dhe e verdha-hënë dhe e hirta-qiell i
shkretë.

Gjithçka jetë!

Një vajzë e bukur nga një roman nxori
për herë të parë një thënie që s'ishte
dashurore.

Njeriun të shquar, thoshte ajo thënie,
e bën, së pari, dashuria njerëzore.

BALERINA

Kjo balerinë sonte për ne
në sallë ish dhe shelg dhe bredh
dhe mal dhe erë dhe gur dhe lule
dhe horizont dhe det.

Një re e bardhë, një trup i hajthshëm,
violinë nëpër gishtérinjtë e zemrës.
Një duartrokëtje në fund — shumë pak!
Më tej harresa — vdekja e vdekjes!

Të dashur, spektatorë të dashur,
mos e haroni balerinën!
Për ju braktisi shumë ndjesi,
nuk meriton t'i ktheni shpinën.

Beli i saj nga profesioni
fugë ish në duart e partnerit
dhe pa asnje paragjykim
për hatër tonë në sup i ndenji.

BALERINA

Ama, në jetë ajo nuk dridhet
nga dora e dashurisë në bel,
siç dridhem kur na prek së pari
dhe fërgëllojmë si një shelg.

Ajo nuk ndizet si ne të gjithë,
shumë pasione i dogj në skenë...
Të dashur, spektatorë të dashur,
duartrokiteni edhe në jetë!

PËRQAFIMI

*Po fryn nje erë e ngrohtë nga jugu,
në park ngadalë përkulen pemët,
si krahë të dridhshëm të dashruuarish
në përqafim ndërthuren degët.*

*Dhe mua më kujtohesh ti,
e ngrohtë, e bukur si kjo erë,
me krahët lidhur pas trupit tim,
për puthje etur dhe pamjemjerë.*

*Çfarë mrekullie do ish të vije,
në sup symbyllur të rrije prapë
dhe puthja jote si dorë artisti
ta kthente gjoksin tim në kitarë.*

*Po ti s'vjen më. Mjerisht s'vjen më.
Veç motin ngroh e dërgon erë,
që unë të qaj me një lot,
që unë të përqafoj një pemë.*

P E N D E S A

Në mal mes luleve një lule e fishkur
dhe përmbi të rrinte një bletë.
Udhëtari ishte duke ikur,
por mbeti shtang si dru i prerë.

Me shpirt ofshau: ç'është dashuria,
ç'dhimbje e mall përzier bashkë!
Kjo bletë s'ka ç'merr nga pleqëria,
po këtu e sjell lulja e parë.
Dhe nuk e sheh që s'është më lule,
sërisht me gjuhë mjalti i flet...

Pastaj, tek shkon, se pse i duket
sikur është thumbuar keq.

SËRISH SI DJALË ÇAPKËN DO FISHKËLLEJË HORIZONTI

1.

*Sërish si djalë çapkën do fishkëllejë horizonti
këngën e diellit në dritare.*

*Gjumashëve një gur i gjelbër
do t'u qëllojë në shtrate.*

*Erdhi pranvera. Mushkëritë
të dehen nga aroma e barit kanë nevojë.*

*Erdhi pranvera. Trishtimin
një re e bardhë e hipë, si varkë me vela.*

Dhe ja tek u ngrit si e marrë era.

Ç'd iñen, ç'duhen, vërtet, njerëzit e trishtuar?

2.

Ra nata.

*Më shpejt atë e solli
trishtimi i hirtë i shokut tim.*

*Me tymin e cigares së parë
zhvirgjeron mushkëritë.*

*Si hënë në natën e tij,
magjepsëse e dritëplotë —
ti.*

*Rrotullohet bota
mekanikisht.*

*Ditë-natë,
ditë-natë...*

*Shoku im, i dashuruar pas hënës,
rri në natë.*

*Po dashuria nuk është astronomike,
dashuria —
robina e njerëzve të gjallë!*

3.

Ra nata.

*Si një lot i madh
nata ra.*

*Unë si i dehur me shishe do ta qëlloj këtë
hënë,
do ta thyej në copëra të mëdha.
Atëherë ai do shohë se ç'zi zezon
Pas asaj buzëqeshjeje të verdhë hënore.*

4.

*Hëna u zverdh edhe më,
si kone e rrahur kërkon ndihmë.*

Po mëshirë përpara kamës vrasëse s'ka!

Shoku im i hollë si shelg,
i gjelbër mbi ty u përkul,
Të dashuroi,
Me pjalmin e dashurisë fluturoi pas
~~IMPATUJ~~ premtimit që i dhe.

pranë lumit tënd u ngul,
Tani ti kërkon të ikësh në qiell,
le të thahet, thua, shelgu pa lumin pranë,
horizontalja, thua, më duket varr,
në qiell të shohin të gjithë!...
Mospërfillja fluturon si nga hobja,
u kthye në trishtim,
Shelgu edhe më u var.

5.

Hëna u thye.

Lumi mori arratinë.

Po shelgu i gjelbër mbeti.

Në kohën tonë lumenjtë
ndërrojnë rrjedhën në rendjen pas
dashurisë.

Shoku im le të qajë me një lot
dhe le të niset si Kolomb mbi këtë pikë loti.
Do ta gjejë, do ta gjejë dashurinë!
Ai është i gjelbër. Sérish për të!
si djalë çapkën do fishkëllejë horizonti.

FUNDI I FLUTURIMIT

*Ky fluturim një fund e paska,
shumë të trishtuar dhe heroik.
Detin përjetë e la pulëbardha,
përpjetë mbeti mbi shkëmbinj.*

*Ky fluturim një fund e paska:
një vetëtimë e bardhë, e bardhë.
Trupngrahtë, si puthje pa dorashka,
në dy shkëmbinj kërkoi varrë.*

*Një lot përloti peshkatarin,
në breg nga rënia lindi sentenca;
Në jetë shumë dashuri të dalin,
po nuk harrohet ku nisijeta!*

*I bukur deti. Mbi të një jetë:
Veç në shkëmbinj veza u ngroh!
Në det nuk mundka shpendi të vdesë,
prehjen e madhe në djep kërkon.*

JETËSORE

Ja, ra mbrëmja. Ti s'je më.

Ku ke shkuar? Unë s'e di

Ne u prishëm për hiç gjë

edhe gjatë do mbajmë mëri.

Dhe kështu, gjersa një ditë

të na thotëjeta «harro»,

Ne do ktheheminë përemra,

unë «ai» dhe ti «ajo».

Do harrohen telefonat,

sytë tanë do thahen pellgjeve,

si prelud do bjerë nga qielli

një dëborë — zkokth i reve.

Po s'do bëhemiqaramanë:

«eh, m'u thye mua èndërra!..»

sytë tanë kur të takohen

s'do të kenëurrejtje brenda.

NJË MBRËMJE UNË DO TË VIJ

Një mbrëmje unë do të vij,

*po të jem gjallë
do të jem fjalë,*

*po të më presësh
do të jem puthje,
në qofsh harresë
do jem kujtesë,
po të jesh varr
do të jem lule.*

*Një mbrëmje unë do të vij
kaluar mbi një kalë të bardhë.*

*Në këtë shekull sofistikimi
hije e trupit m'u bë ky kalë.*

*Ndoshta mbi shpinë mban rininë time
dhe tënden dhe njerëzimin bashkë.
Dhe hingëllin me pikëllim,
unë i gjalli, groposa ca fjalë.*

KENOE DVSHURE

Një mbrëmje unë duhet të vij,
sërish i mirë, sërish i ri.
Diçka e fika dikur te ti,
me tmerr të shoh tek rri pa dritë.

Atëherë unë ika, po kali i bardhë
gjithë mirësitë që në rrugë lashë
m'i mblođhi.

Tani hingëllin.

Kjo hingëllimë nga sheshi i zemrës,
herë lutet, herë thotë me zë therrës:
O hipmë,

o më vrit!

KĒNGĒ DASHURIE

E dashur, erdha! Pse vrenjtesh kot?

Ti po më prisje mua.

*Mos u çudit! Unë jam një zog,
e ngre folenë ku të dua!*

*Kur dashuroj, behem si ajri,
do s'do, të futem në kraharor.*

*Do të pushtoj me zjarr të marri,
po mbylle derën, do ta copëtoj!*

*Do bësh sikur më ke inat,
ndodhi e vjetër, unë e di!*

*Po s'jam buzëqumësht, jam esnaf,
për dashuri di plot dredhi!*

*Unë do të puth dhe në ngritsh dorën,
dhe në më ç'jerrsh me thonj!*

*Vetë queshe, vetë e ngrohe kohën,
dhe fluturova këtu, jam zog!*

Né se
do shihni
xetoren tim

E ðashur, erdha! . . .

Né prag ke dalë,
ke hapur portën, qesh nën hundë:
— Sa përbetohesh né qindra fjalë,
eja , hyr brenda, mos fol dhe puthmë!

ZJARRI

*Mesnatë. Cigaren e fundit flaka nga ballkoni
dhe harku i zjarrtë në tokë u shua.*

*Jeta ime le të bjerë kështu,
veç deri ditën e mbrame zjarrin ta ruaj.*

SHIKOJ NË RRUGË

*Shikoj në rrugë një lule të flakur,
shkelur përdhunshëm, të tharë, pa aromë,
Ca ditë më parë petalehapur
të mrekullonte — kish rrënje në tokë.*

*Po, ja, dikush e desh të tijën,
dorën e zgjati dhe e këputi.
Ngadalë petalet zunë dhe u fishkën,
shkoi bukuria, aroma humbi.*

*Mendoj për fatin e njeriut,
s'ndodh si kjo lule të këputet?
Dhe bukuria, si lumë pas shiut,
përbaltet llumrave e zhdukët.*

*Ta shihnim gjith' lulen përpara,
në jetë do silleshim më me kujdes,
se dhe gjeniu nga moskokëçarja,
për fat të keq, vyshket e vdes,*

PO BISEDË ME MODESTINË

Ka njerëz
të paaftë
që duan
madhështi.
Këta
po na ftohin
me ty,
modesti.

1983

JETA IME

Trishtimi. Ai vetëm mua më përket!
Iku një vajzë. E desha dhe i thashë:

Jeta ime bohemë në dy metra katrорë vdes.
Vdekja! Ç'fjalë e trishtme dhe e fortë!

Nuk vdes njeri nga një dashuri e humbur.
Sidoqoftë, dhembje ka.

Edhe vdekja në metastaza dhembjesh është
e struktur,
galopi i tyre baraz me hata,

Po bota jeton. Jeton njeriu.
Me dhembje, dhe më i lumtur.
Unë dua të jetoj.

Ajo gjithashtu. Dhe
iku.
Trishtimi vetëm mua më përket! Për inat të
tij bëhem më i bukur!

PO LULËZOJNË SËRISH PEMËT

*Po lulëzojnë sërish pemët,
në degë lule,
dielli-frut.*

*Dhe ky gjethim i madh i tokës
në një trishtim
se pse më fut.*

*Ndoshëta se ndiej pafuqinë time
ta mbaj të gjallë
dashurinë,
të çel prapë lule, të zë prapë kokrra
dhe mos ta njoh
shterpësinë.*

*Po lulëzojnë sëri sh pemët,
bota i mposhti erërat acar.*

*Cudi, nga kjo pranverë e madhe
tek unë si s'fluturoi pak pjalm?
Të lulëzoja prapë si dikur
në vargje, këngë e fjalë,
të zgjoja hyjnin' që s'vdes kurrë,
ndjenjën — prindin e parë.*

SA PAK KAM BESUAR TE VETJA

1.

«*Ma jep kalemin!
Do shkruaj te qielli!...*

Livadhi është krevati...

«*O ba, tunde tokën!
Una do bëj nani-nani!...»*

2,

*Në metaforat mahnitëse fëmijërore
bota dashurohet e transformohet.*

*Ne shpesh plogështohemi e ndryshkemi kot,
nuk besojmë se mund ta lindim mrekullinë.
Trustakuar udhëtojmë kuturu, si trena bosh,
kemi harruar në stacionet e viteve
fëmijërinë...*

3.

*Im bir drurin e bën njeri,
megjithëse për Pinokun nuk di asgjë.
Unë trishtohem: sa pak kam besuar te vetja
dhe sa shumë mund të bëj.*

NË KËTË NDARJE

Ra nata.

*E zezë dhe e mëndafshtë
si sytë e tu.*

*Këndon një hutin, unë
të kërkoj trishtuëshëm në kujtimet që la
koha.*

*Këndon hutini dhe fundin e kujt profetizon:
timin,
tëndin
apo të kujtesës?*

*Shkoj nëpërëndërr me hutinin në sup.
E godas. Pastaj, për të bëré fustanin tënd të
atëhershëm.*

gris një copë qielli blu.

*Hënën thyej
për ta bëré mollëza.*

Hutini mallkimtar këndon.

*Askurrë s'kam besuar te trishtimi dashuror
i zemrës,
te vdekja
askurrë!*

NIE PLATE LIBRI I VAILOVSKA

Por,
si në baladën ku vajtojca qan të gjallët,
edhe mua
hutini i ndëshkimit të ndarjes trilltare
më gjen në çdo skutë.
Bota është bujare.
Gjithë ç'kishte
ma dha.
I dhashë trupin,
mendjen,
zemrën,
dashurinë.
Po krahu im u tha.
Trilli të përzuri.
Atje vari
vetminë.

Dhe hutini
bën veprimin më të kobshëm:
s'këndon më!
Domethënë...

*Brenda gjoksit tim është strukur vetmia,
më grryen.*

dhe e grryej.

Vetmia mua apo unë brenda gjoksit po them:

Ku je...

Ku je...

Kuje...

NJË FLETË LIBRI E PALOSUR

fletë *paksa* *per* *nesër*
Një fletë libri e palosur paks
për të jetuar vazhdimisht nesër.
T'i kisha palosur kështu ditët e mia kur
dashuroja,
s'do isha kaq i vjetër.

DHE PRAPË, DHE PRAPË

*Trishtimin tim askush s'ma di
dhe s'dua të më shohë askush.
Im atë po ikën, në gjoksin tim
një mijegull kuje hapësirat mbush.*

*Veç gjoksi im i vogël është
dhe matet me pëllëmbë.
Ndërkokë vendit pranvera mbiu,
sado që zemra të më dhembë.*

*Përmes ringjalljes trishtimi im
do bridhte si një Don Kishot,
sado i mirë të jetë im atë
edhe trishtimi njerëzor.*

*Ky gjelbërim edhe kjo stinë
më thonë: eja, mbill një pëmë,
që vitin tjetër më pak trishtim
e më shumë jetë rrugët të kenë...*

Mos duan
Thone

Unë do të mbjell jo pemë, po parqe,
paçka se gjoksin kam plot trishtim.
Edhe në qaj, me lot
pemët që mbolla do t'i vadis!

XXX

Baba, kush të tha
se ajo rrugë e zezë
qenka e kaltër

Ti kthehu!
Ti kthehu!
Ti kthehu!

Rruga është e zezë,
përjetësisht e zezë,
një perçe zie,
një prag vdekje
te vdekja të shpie.
Kthehu!
S'ka dritë...

Por, ah, mizorisht të mbërtheu
me ato meduzat në terr të fshehura,
si gropat e maskuara-gracka për luanët.

*Kurse ti, ti qesh dhe thua:
rruga ēshtë e kaltér...*

*Ti kthehu, baba!
Atë e kaltérojnë
vetëm dritat e syve të tu.*

*S'ēshtë e kaltér ajo rrugë.
Ēshtë e zezë,
mizorisht e zezë.*

*Por ti tund kokën kokëfortë si fëmijë,
ikën drejt saj mospërfillës.
Rruga t'i zbut dhimbjet dhe ti
sakaq andej sheh dritë të kaltér,
duke harruar se vdekja mbetet dhimbja më
e madhe,
duke harruar se vdekja ka nxjerrë sëpatën
ta copëtojë e ta humbë dritën e kaltér,
baba, . .*

NJË NJERI BREDH NË VARRE

Çdo ditë e shoh tek bredh në varre,
i hirtë vjen e shkon i bardhë.

Një metastazë galopante
këtu në gjumë i bie ngadalë.

Këtij njeriu brengën ia di
dhe dyluftimin-tmerr të vërvetes
mes ditës dhe natës pis, —
ç'do mbretërojë në shesh të zemrës?

Ai do ditën, por ambiciozi
me forcë natën e tërheq.
Dhe vjen njeriu çdo ditë i kërrusur,
për t'u drejtuar mes varresh bredh.

I thotë vetvetes: ç'bëhesh makut?
Një ditë do vdesësh edhe ti.
Sa kohë që lodhesh me intriga,
puno të lësh një mirësi...

*I hirtë vjen e shkon i bardhë,
Them s'do të vijë më. Sërish vjen nesër.
Shumë dyluftime ka në botë,
ky në vetvete është më i egër!*

D A K A-U

Dasëm+karrierë

*Ftesat
e dasmës
u shtypën
me mik —*

TË VECANTAL

*Për vizitë
njerëzit
pa pushtet.
Për darkë
emra!*

*Shokët
u harruan,
u thirrën
ça kolegë
(sy, veshë e gojë
dëshmitarë
ç'dasmorë pati në dasëm
ditën e nesërme!)*

*Ftesat
u shpërndanë.*

*Edhe dasma
shkallë
karriere*

«M B R E T I»

Babai mori në Luftë një plagë,
i biri plagën e bëri kalë.

Babai mori në Luftë një ftohmë,
i biri sot seç paska kollë.

Babai është burrë i ndershëm,
me këtë shpatë djali çan jetën,
babai ka shumë shok e miq,
i biri emrat përmendsh ua di.

Dhe mbi të gjithë kalëron.

Mbi kalin — at e mori shkollën,
mbi atin-mik mbrojti diplomën.

Elez Ali u bë me plagë
derisa ndenji në Tiranë,
Dhe për atë ftohmën e vjetër
një punë desh dhe gjet në qendër.

Se mbi gjithçka kalëron.

Babai-kalë,
plumbi-shalë,
migtë-frerë,
djalì çan dhenë.

Dhe kalëron.

Thotë: ç'ta vras mëndjen?!
Ç'duhet, më mbetë?!
Ca luftë, punë e ndershëmëri
m'i la babai me tapi.
Kaq më mjaftron!

Dhe ati hesht
dhe bëhet kalë,
mbi shpinë mban
një gjunjëdalë.
Ky djalë në dorë
mban një baket,
si dirigjent,
dhe...
ndihet mbret!

NJËHERË, KUR ISHA I RI

Njëherë, kur isha i ri, me erën luaja e
bëhesha zog,
qiellin e gdhendja dhe formoja portretin e
dashurisë,
isha edhe sy poeti në tokë dhe hënë në
horizont,
sfidant isha, shtratin e dashurisë e bëja me
qiparisë.

Njëherë, kur isha i ri, njëherë;
tani rri mendohem: kam qënë vërtet i ri
ndonjëherë?

BALADA E RE E KALIT MAGJIK

1

*Kur i thoshin «pse s'punon karrocierit plak,
ai mbrohej «ç'të bëj unë? Nga këta kuaj të
kap data!*

Një gërdallë, një i çalë, tjetri injorant!

*I tërheq frerin e majtë, ai kthehet nga e
djathta!..»*

2

*Po dita i solli në karro karrocierit
një kalë të pahasur as dhe në legjenda.
Mjaftonte ta mbrihje dhe s'qe nevojë e
frerit,
kali fluturonte i lehtë si penda.*

*Mbaronte çdo punë hap e myll sytë,
e zgjaste ditën me dhjetëra orë
dhe s'dinte ç'është kafja e parë, e dytë,
konjakun e sabahut s'e njihte kali i gjorë.*

*Atëherë karrocieri e ktheu pllakën,
ia rrasi kafshës frerët thellë në nofull,
prapë zu avazin si me gërdallën,
ngarko një orë, tri orë hajde rrotull.*

*Ky kalë i poshtër, shante me vete,
më do dhe mua çdo çast më këmbë
dhe po pranova, është kalë për shtatë palë
do ngrihen normat, dynjanë do ha me
dhëmbë!*

*Do dal i paaftë dhe marsh në pension,
zvogëlohet rroga e s'ka më pallë,
prandaj, sa kohë freri rron,
shtrëngojë ta kthejmë dhe këtë në gërdallë!*

3:

*E ndau mendjen karrocieri,
një fjalë të mirë kalit s'i tha.
Deri në mish depértoi freri,
në kockë një brazdë shenje la,*

*Dhe shty një vit e shty dy vjet,
u plak kali magjik.
Dhe karrocierit i erdhi «keq»,
liroi frerët një çikë*

*Sepse në jetë s'ndodhin magji
dhe kali s'hapte më telashe.
Kështu ngadalë pikoi një ditë
kur kali shkoi e vate.*

*Atëherë na qau karrocieri,
me lot u la në funeral...
— Vellezër, sot vajton dhe freri,
ish dëli kalë për fushë dhe mal...*

*I tillë qe... Rreshto merita,
dhe s'tha për be asnje gjënjeshtë!
Po ķalin dhe në varr si krimba
do ta shkallmonin frerët...*

HISTORI NË KOPJATIV

Xhuljetën e ndanë me jetën,
Romeon e ngjitën në Panteon,
vetëm mos ishte më i gjallë, —

shterpësinë dashuria e shkallon!

Kjo është ndodhia dhe historia,

Xhuljeta, Romeo, kujtesa...
Po thonë, kujtesa lind nga jeta.
Dhe, meqëjeta s'dashka të harrojë,
po dashkan të thonë,
ende këto dashuri
atje, atje, pra, në varr
ende shkojnë.
Sepse rron shterpësia
dhe, siç po thonë, pra,
atë e çmend dashuria.

Xhuljeta, Romeo,
dhe unë dhe ti.

Jeta është e bukur
me
apo
pa
dashuri?

Me —
në varr dhe në kujtesë,
pa — /
i vdekur që pret të vdesë.

Në këtë udhëkryq
breza të tërë
ende rrinë.

Mos duan të thonë se ky shekulli XX
vërtet modern është,
veç mbaka
dhe pakëz
erë
vjetërsirë?

TANI

Tani u rritëm,

*Në varreza s'endemi më kuriozë
mes së panjohurës.
Vërtitemi, të zbehtë,
takojmë të njohurit.*

Tani u rritëm.

*Fjalitë i nisëm me «mos»,
ëndrrat konservojmë në libreza kursimi,
e qeshura s'është më serioze,
as vajtimi.*

Tani u rritëm.

*Na pëlqen rregulli i trashëguar,
sido qoftë ai!
Mos thyeni rregullat... Zbatoni rregullat...
Një irregullore e hershme jemi tani.*

Tani u rritëm.

Vdekja ka shtënë dashuri me ne
dhe do të na tundojë me rradhë,
sipas rregullave t'i dalim në takim
atje,

te qiparisat.

Jemi rritur tanë, ndaj do ta zbatojmë pa fjalë
edhe këtë rregull të lashtë.

Peizazh



Bequia

3

PERËNDIMI

*Dielli gjakëroi si një plagë nën sisë,
këmisha e qiellit u bë e purpurtë.*

*Kush, vallë, kujtoi shokët
e mbetur në Luftë?*

PO ZBRET NGA QIELLI NËPËR NATË NJË DRE

*Po zbret nga qielli nëpër natë një dre
me brirë mahnitës vetëtimash.
Ai zbret, dredhëron nëpër shtigje resh,
herë-herë brirët ndrisin me dritë hënash.*

*Ia dëgjoj dihatjen e lodhur bukurisë,
trokëllimën e çrregullt të thundrave nëpër re,
Gjahtarët e qëllojnë mizorisht nga pas,
pas flakës së krismës shfaqen brirët vetëtimthi.*

*Ai po zbret nga qielli nëpër natë,
si perëndi e zgjuar nga gjumi i nisur para erës
I bukur, i mrekullueshëm, magjepsës
po vjen të gropohet.*

Perënditë, s'rrojnë dot në tokë.

QIELL PRANVERE

Qiell dhe qiell i kaltër, i pamatë,
syrin e trembin kufijtë.

Megjithatë, zogjtë shtegtarë
drejt përtëritjes fluturojnë vazhdimisht.

Atje tej, kū ende s'duken, janë
vendet e ngrohta dhe jeta.

C'do lindin ua zvogëlon qiejt e paanë,
dielli u duket si çerdhja.

Do vdesin disa në këtë udhë
të gjatë, po jo pa mbarim.

Drejt jetës shtegtofsha gjithmonë edhe unë,
dhe si zog le të vdes në udhëtim.

DYSHIM PRANVEROR

Një zemër varresh zbardh në kodrinë,
i thikte, përmendore qiparisi.
Pas shpine, pastaj, vargan i ullinjev të
moçëm, o njerëz, pse vdisni kaq shpejt, sikur klithi.

Pranvera tek shkoi në agim aty pari
mbi varre la një dorë bar të gjelbër,
a thua të vdekurit ia kërkuan,
a thua të gjallë i folën si në ëndërr.

Vërtet, të gjallë a të vdekur janë?
Në pllakat e mermerta gërshërët e viteve
thonë: nuk rreh kjo zemër e gurtë në kodër!
Por në këmbët e varreve lulnaja e kuqe e
pjeshkëve
ka mbushur me gjak venat e tokës.

KEMISHT-NË TËL

O mëmë natyrë, ç'ndodhka në pranverë
me këto mijëra ngjyrëza të lashta e të reja?
Kjo bukuri e patradhëtueshme
të bën të dyshosh se ekziston dhe vdekja.

Vërtet, të gjallë a të vdekur janë?

Amidhësi është mëllurë, lloja i
vërtetë, gjithashtu është qëllimi
qëndrues i bimës së tij. Në
nëntorë është qëllimi i tij bimës

Të paktën, qëndrues i tij është
qëllimi i tij, qëndrues i tij
është qëllimi i tij, qëndrues i tij
është qëllimi i tij, qëndrues i tij

KËMISHËT NË TEL

Këmisha të ndera në tel.
U lanë. Të pastra prapë janë.
Pastaj do bëhen pisë,
pastaj sërish do t'i lajmë.

Der' ditën kur do të treten,
atëherë, marrsh në kosh!
Këmishët e reja në tel
do shfaqen të bukura si zogj.

I shoh, më pushton një trishtim,
kujtoj më të pastrën, zemrën.
Në jetë gjithkund ia kërkova,
askund nuk ia gjeta shemrën.

Po zemra na bëhet me pluhur
në skuta egosh, mérish.
E dimë, s'kemi tjetër, e lajmë me kujdes,
po zemra nuk është këmishë.

*Një ditë vjetërohet e tretet,
atëherë marrsh në kosh!
Po zemra nuk është këmishë
dhe trupi pa të — arkivol!*

RIPERTERITJE

Cicerojnë zogjtë, cicerojnë,
pemët kthehen në kitara.

Në një stinë jetoj me zogjtë,
në një tokë
dhe e ndiej se s'kam pranverë
po s'këndova prapë nga e para.

PRANVERA

Pranvera erdhi!
Njerëz të sëmurë,
ju lutem;
mos vdisni!

Vajza të dashuruara,
ju përgjërohem,
harrojini mëritë!

Ka ardhur pranvera
dhe ç'pikëllim
të hasësh në rrugë trishtim të gjelbër...

FORCE

Hapi krahët!

*Në gjoksin tënd Dajti
u struk si foshnjë.*

*Jo ti,
natyra
është foshnja jote!*

DASHURIA I

Plepat kokëvarur në fushë
si fëmijët mbi një këmbë
të dënuar nga prindi pedant.
Ç'faj bëtë, i pyet era,
ç'faj?

Të brishtët
mbi një këmbë.
Në sqetulla degësh
mbajnë hënën e verdhë —
fole pëllumbash plot me vezë.
Era bredh fushës skaj më skaj:
Më thoni, pra,
ç'ishte ky faj?

Ata fëshfërijnë.
Mbi një këmbë
ngrohin folenë.
Kështu, ja, kështu,
derisa të gdhijë,

derisa vezët të çukiten nga pëllumbat e
bardhë,
nga pëllumbat që sakaq do përhapin puplat
fluturim nëpër qiel,
derisa vezët të bëhen shpendë
dhe shpendët ditë
dhe plepat më folenë e verdhë nën sqetull
s'do ta mbajnë.
Atëherë era do fashitet,
s'do pyesë më,
veç do nisë të shkrujë heshturazi në qiel
me gërmat e reve puplore:
— Sidoqoftë,
plepat mbrëmë bënë një faj,
prandaj...

FRYMA NË XHAM DHE BOTA NË DRITARE

*Një vajzë e bukur trishton pas dritares
për vështrimin, dashurinë e humbur.*

*Si t'i them vajzës: kujdes, e dashur,
pas xhamit bota vjen e turbullt!*

*E turbullt, e turbullt ; si e parë nga miopi
dhe dashuria me ato shenjëzat e saj do
zhduken fare...*

*Si t'i them vajzës: kujdes, e dashur,
e turbullt vjen bota në dritare!*

ERA

Frym erë.

Shelgjishtet buzë lumit
përkulen si pleq japonezë
dhe drurët e njomë
temenara bëjnë deri në tokë,
gjethet fëshfërijnë me ngut
si duartrokositje pa fund.

Dhe pse?

Dhe pse?

Sepse

frym erë!

Përkuluni, drurë,

gjethe, duartrokisni!

Sikur t'ju imitonin njerëzit ju
s'do hasje në peizazh më të mjerë . . .

PEHLIVANËT E SKEMATIKUT

*Kolombi e theu pak vezën atëherë
dhe veza qëndroi pingul në tryezë.*

*Ta dinë këtë gjë, skematikët bëjnë hatanë:
u presin një këmbë njerëzve,
po t'u duhen pehlivanë..*

DASHURIA II

*Natën,
kur bie
të fle,
ti më ulesh në qerpik.*

*Në mëngjes
të laj sytë
kam frikë.*

1982

NJË RE E BARDHË DHE KRISTOFOR KOLOMBI

Një re e bardhë atje në skaj
më përngjasoi varkë me vela.
Të isha unë Kolombi i saj
do të zbulojë vise të reja.

Kjo botë varka paska plot
për udhëtime drejt së resë.
Po jo kushdo bëhet Kolomb
dhe jo kushdo nuk mund të vdesë.

Nga èndërra der' te realiteti
është padyshim rrugë e gjatë.
Një privacion èndrrën e treti,
i vetëm mbeti Kolombi prapë.

Dhe reja mbeti siç ishte, re,
shtrigane dolën vështirësitë.
Të jesh eksplorator mbi dhë
duhet guximi, jo llogaritë.

PEIZAZH DIMËROR

Brymë mbi tokë,
kuaj mbi brymë.

Kokat ngrenë lart,
nga hundët qielin
shatërvanë avulli e shpojnë
si rrugë avionësh.

Do fluturojnë?

Mes bukurisë
vdekja troket.
Cili kalë
do shkojë me të?

Brymë mbi tokë,
kuaj mbi brymë.

N D O N J Ě H E R Ě

*Ndonjëherë do të të them sa të dua,
ndonjë mesnatë...*

*Ndonjëherë, värtet. Dhe nëse deri më sot
kam heshtur,
kam pasur frikë se ti do qash...*

DET!

Eshtë kaq i qetë ky det,
i urtë, babaxhan.

Po kalë s'e bën dot,
në gojë frerë s'mban,

Anijet mban mbi shpinë,
njeriun lumturon,
se vëtëm jetës shpinën
deri në tokë ia shtron.

Më ngjan me atin tim,
për mua bëhej kalë,
të qeshja me gaz foshnjeje,
mos kisha rrudhë në ballë.

Po ati im i mirë
në jetë s'mbante frerë
trilltarësh të hazdisur
të lindur për bejlerë.

*Eshtë kaq i qetë ky det,
po mos e ktheni kalë.*

*Do flakë urtësinë,
një xhind do jetë me dallgë.*

*S'do ketë kohë për pendesë,
kur të buçasë për tmerr.*

*I urti s'kthehet kalë,
parajssë është, por, dhe ferr!*

REVOLUCION

— Etyd —

Këtu gjithë hoxhiët i zuri astma,
nuk ngjiten dot në minaré.

Dhe hëna s'duket më mbi çallma
një kokërr ve,

Gjithë feudalët karagjozë
si një theks fjale i vënë gabim
s'u kthyen dot as Don Kishotë —
forcë s'kishin dhe për èndërrim!

... Kur një figurë poetike
vdes dhe rilind figurë tjetër,
beso: ne sollëm të renë magjike,
me farë e zhdukëm botën e vjetër!

Përbajtja

KANTATË PËR NJERIUN

Naim Frashëri	5
Gratë	6
E di, pas dere do pres një çast	7
Selvitë në varreza	8
Kjo foshnjë që lëviz në bark të nënës	9
Tani	10
Së pari, dashuria njerëzore	11
Balerina	13
Përqaftimi	14
Pendesa	16
Sërish si djalë çapkën do fishkëllejë horizonti	17
Fundi i fluturimit	20
Jetësore	21
Një mbrëmje unë do të vij	22
Këngë dashurie	24

NËSE DO SHIHNIT ZEMRËN TIME

Zjarri	29
Shikoj në rrugë	30
Bisedë me modestinë	31
Jeta ime	32

Po lulëzojnë sërish pemët	33
Sa pak kam besuar te vetja	34
Në këtë ndarje	36
Një fletë libri e palosur	39
Dhe prapë, dhe prapë	40

MOS DUAN TË THONË...

X X X	45
Një njeri bredh në varre	47
Daka-u	49
«Mbreti»	51
Një herë kur isha i ri	53
Balada e re e kalit magjik	54
Histori në kopjativ	57
Tani	59

PEIZAZH

Perëndimi	63
Po zbret nga qielli nëpër natë një dre	64
Qiell pranvere	65
Dyshim pranveror	66
Këmishët në tel	68
Ripërtëritje	70
Pranvera	71
Forçë	72
Dashuria I	73
Fryma në xham dhe bota në dritare	76

Era	76
Pelivanët e skematikut	77
Dashuria II	78
Një re e bardhë dhe Kristofor Kolombi	79
Peizash dimëror	80
Ndonjëherë	81
Deti	82
Revolucion	84

robert, 1972

Albanian; Shqipëri i vërtet i vërtet

; 7 : - [Militari] ; belli ; qezek zotëruar

; i 88.0001 ; 115x150 mm

1972.01

I - 280.125

1981. rindëri është 50 mijë kushtet. I
1981. rindëri është 50 mijë

50 - 1982. rindëri është 100 mijë. Njëzet e njëjtë
është e saktësuarë. L. 1982. rindëri është 100 mijë.
1982. rindëri